



## SYLLABUS I LËNDËS “E DREJTA KUSHTETUESE”

| Të dhëna bazike të lëndës      |   |
|--------------------------------|---|
| Njësia akademike:              | Fakulteti Juridik   |
| Titulli i lëndës:              | E drejta kushtetuese  |
| Programi:                      | Juridik i përgjithshëm  |
| Niveli:                        | Bachelor  |
| Statusi lëndës:                | Obligative  |
| Viti i studimeve:              | Viti i I-rë, Semestri i II-të   |
| Numri i orëve në javë:         | 3+2   |
| Vlera në kredi – ECTS:         | 7   |
| Koha / lokacioni:              | Fakulteti Juridik   |
| Mësimdhënësi i lëndës:         | Prof. Asoc. Dr. Kadri Kryeziu   |
| Të dhënat kontaktuese:         | <a href="mailto:kadri.kryeziu@uni-prizren.com">kadri.kryeziu@uni-prizren.com</a>  |
| <b>Përshkrimi i lëndës:</b>    | Studentët përmes kësaj lënde do të analizojnë konceptet themelore kushtetuese, burimet e së drejtës kushtetuese, sistemet dhe institucionet kushtetuese, llojet e kushtetutave, aspektin kushtetues të sundimit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Po ashtu, do të trajtohet shkurtimisht edhe sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës.   |
| <b>Qëllimi i lëndës:</b>       | Kjo lëndë ka për qëllim që t'i mësojë studentët e studimeve bachelor me pjesën teorike të së drejtës kushtetuese si degë e veçantë e së drejtës, ku ata do të kenë mundësit t'i analizojnë konceptet themelore kushtetuese, sistemet dhe institucionet kushtetuese, burime e së drejtës kushtetuese, natyrën dhe llojet e kushtetutave, aspektin kushtetues të sundimit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës, parimeve dhe strukturës kushtetuese në Kosovë përfshirë këtu organizimin dhe fushëveprimin e organeve kushtetuese të Republikës së Kosovës. |
| <b>Rezultatet e të nxënit:</b> | Pas përfundimit të suksesshëm të ligjeratave studentët duhet të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të kuptojnë dhe njohin konceptet themelore kushtetuese</li><li>• Të kuptojnë institucionet themelore juridike dhe politike të sistemit kushtetues;</li><li>• Njohuritë e gjeneruara nga kjo lëndë t'i materializojnë në praktikë.</li><li>• Të përvetësojnë njohuri edhe për sistemin kushtetues në Republikën e Kosovës;</li></ul>   |



|  |  |                  |                         |
|--|--|------------------|-------------------------|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Të aftësohet për interpretimin e dispozitave juridike nga kjo fushë.</li> </ul>   |                  |                         |
| <b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b> |  |                  |                         |
| <b>Aktiviteti</b>  | <b>Orë</b>   | <b>Ditë/javë</b> | <b>Gjithsej</b>         |
| Ligjërata  | 3  | 1/15             | 45                      |
| Ushtrime teorike/laboratorike  | 2  | 1/15             | 30                      |
| Punë praktike  |  |                  |                         |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet   | 1  | 1/15             | 15                      |
| Ushtrime në terren   |  |                  |                         |
| Kollokfiume, seminare  | 1  | 1/1              | 1                       |
| Detyra të shtëpisë   | 1  | 1/5              | 5                       |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)                         | 3  | 15               | 45                      |
| Përgatitja përfundimtare për provim  | 2  | 1/11             | 22                      |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)  | 1  | 1/8              | 8                       |
| Projektet, prezantimet ,etj  | 1  | 1/4              | 4                       |
| <b>Totali</b>  |  |                  | <b>175 orë (7 ECTS)</b> |
| <b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>  | <p>Metodologjia e mësimdhënies do të konsistojë në ligjërimitin e lëndës në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për studentët sikurse edhe në analizën e thellë të tematikës përkatëse.</p> <p>Ligjërata do të prezantohet sipas metodës interaktive.</p> <p>Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të lëndës dhe të mundësisë për ndërveprim më të madh në klasë, është erekomanduar që studentët të lexojnë paraprakisht materialet për temën e cila do të diskutohet në orën pasuese.</p> <p>Studentët inkurajohen të bëjnë pyetje, komente dhe sugjerime gjatë ligjëratave si dhe të grisin pika të diskutimit në kuadër të temës së ligjërates.</p> |                  |                         |
| <b>Metodologjia e vlerësimit:</b>  | <p><b>Vlerësimi me gojë dhe me shkrim:</b></p> <p>Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ligjërata.....5%</p> <p>Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ushtrime .....5%</p> <p>Punime seminarike ..... 10%</p> <p>Vlerësimi final: .....80%</p> <hr/> <p>Totali: .....100%</p>  |                  |                         |

| Literatura                 |   |
|----------------------------|---|
| <b>Literatura primare:</b> | <p>-Kadri Kryeziu, "E drejta kushtetuese", Prizren, 2017.</p> <p>-Kurtesh Saliu, "E drejta kushtetuese" Prishtinë, 2004.</p> <p>-Arsim Bajrami &amp; Florent Muçaj, "E drejta kushtetuese", Prishtinë 2018.</p> <p>-Kushtetuta e Republikës së Kosovës.</p>   |
| <b>Literatura shtesë:</b>  | <p>-Oliver Duhamel, "Droit Constitutionnel/E drejta kushtetuese-Demokracitë", Paris 1993, përktheu nga frëngjishtja Alba Frashëri</p> <p>-Vicki Jackson "Constitutional Engagement in a Transnational Era", Oxford University Press, 2013.</p> <p>-Rosenfeld, Michel, and András Sajó, eds. "The Oxford handbook of comparative constitutional law", Oxford University Press, 2012.</p> |

| Plani i dizajnuar i mësimi: |  |  |
|-----------------------------|--|--|
| Java                        | Ligjërata  | Ushtrime   |
| <i>Java e parë:</i>         | <b>Prezentim i programit të lëndës dhe metodologjisë së mësimdhënies</b>   | Prezentim i metodologjise së punës në ushtrime                                       |
| <i>Java e dytë:</i>         | <b>Paraqitja e kushtetutave dhe zhvillimi kushtetues në botë</b><br>Prejardhja dhe shkëndijat e Kushtetutës<br>Paraqitja e kushtetutave të para të shkruara<br>Shkaqet e zbatimit të kushtetutave të shkruara<br>Paraqitja e kushtetutave të shkruara gjatë shekullit XVII-të, XVIII-të dhe XIX-të | Përsëritje-paraqitja e kushtetutave dhe zhvillimi kushtetues në botë                 |
| <i>Java e tretë:</i>        | <b>Kuptimi, objekti i studimit, metodat dhe burimet e së drejtës kushtetuese</b><br>Kuptimi i të Drejtës Kushtetuese<br>Rëndësia e së Drejtës Kushtetuese  | Përsëritje-kuptimi, objekti i studimit, metodat dhe burimet e së drejtës kushtetuese |

|                        |  |   |
|------------------------|--|---|
|                        | Objekti i studimit dhe metodat e të Drejtës Kushtetuese<br>Përmbajtja e të Drejtës Kushtetuese<br>Burimet e të Drejtës Kushtetuese   |   |
| <i>Java e katërt:</i>  | <b>Kushtetuta si akt juridiko - politik i shtetit</b><br>Kuptimi i kushtetutës<br>Teoritë mbi llojet e kushtetutave<br>Vetitë e kushtetutës<br>Përmbajtja e kushtetutës<br>Përbërja (struktura) e kushtetutës<br>Mënyrat e miratimit dhe ndryshimit të kushtetutës                                   | Përsëritje-Kushtetuta si akt juridiko-politik i shtetit<br>Elaborim i përmbajtjes së Kushtetutës së Kosovës, mënyrës së miratimit dhe ndryshimit të saj       |
| <i>Java e pestë:</i>   | <b>Peridoizimi i zhvillimit kushtetues në botë</b><br>Zhvillimi kushtetues nga fundi i shekullit XVIII dhe gjatë shekullit XIX<br>Zhvillimi kushtetues në botë në periudhën midis Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore<br>Zhvillimi kushtetues në botë pas Luftës së Dytë Botërore                    | Përsëritje-periodizimi i zhvillimit kushtetues në botë, analizë e karakteristikave të kushtetutave të caktuara që janë paraqitur gjatë periudhave të caktuara |
| <i>Java e gjashtë:</i> | <b>Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria</b><br>Paraqitja dhe zhvillimi i parimit të kushtetutshmërisë<br>Nocioni i kushtetutshmërisë<br>Përmbajtja e parimit të kushtetutshmërisë<br>Nocioni i ligjshmërisë<br>Përmbajtja e parimit të ligjshmërisë<br>Parimi i sundimit të së drejtës dhe shteti ligjor | Përsëritje-Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria   |
| <i>Java e shtatë:</i>  | <b>Shteti</b><br>Paraqitja e shtetit<br>Nocioni i shtetit  | Përsëritje-Shteti dhe tipet e format e shtetit  |

|                             |  |   |
|-----------------------------|--|---|
|                             | <p>Format e qeverisjes shtetërore</p> <p>Format e regjimit politik</p> <p>Format e rregullimit shtetëror</p> <p>Format e ushtrimit të pushtetit shtetëror</p>  |   |
| <i>Java e tetë:</i>         | <p><b>Organet e shtetit</b></p> <p>Llojet e organeve shtetërore</p> <p>Parlamenti</p> <p>Shefi i shtetit</p> <p>Qeveria</p> <p>Gjykata</p> <p>Prokuroria</p>   | <p>Përsëritje-organet e shtetit</p> <p>Diskutim lidhur me organet e shtetit në Republikën e Kosovës</p>   |
| <i>Java e nëntë:</i>        | <p><b>Evolucioni i identitetit kushtetues në Kosovë</b></p> <p>Historiku i mbrojtjes kushtetuese të drejtave në Kosovë</p> <p>Mbrojtja kushtetuese e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës</p> <p>Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës</p> <p>Përbërja e Gjykatës Kushtetuese</p> <p>Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë</p> <p>Efekt i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese</p>  | <p>Përsëritje-Evolucioni i identitetit kushtetues në Kosovë</p> <p>Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës, përbërja, palët e autorizuara, kompetencat dhe efekti i i vendimeve</p> |
| <i>Java e dhjetë:</i>       | <p><b>Liritë dhe të drejtat e njeriut e të shtetasit nga sfera e së drejtes kushtetuese</b></p> <p>Paraqitja dhe zhvillimi i institucionit të lirive dhe të drejtave të njeriut e të shtetasit</p> <p>Klasifikimi i lirive dhe të drejtave të njeriut e të shtetasit</p> <p>Liritë dhe të drejtat personale</p> <p>Liritë dhe të drejtat politike</p> <p>Liritë dhe të drejtat sociale ekonomike dhe kulturore</p> | <p>Përsëritje-Liritë dhe të drejtat personale, politike dhe sociale, ekonomike dhe kulturore</p>  |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | <p><b>Sistemi i zgjedhjeve</b></p> <p>Kuptimi i sistemit të zgjedhjeve dhe i së drejtës të zgjedhjeve</p> <p>Rëndësia e zgjedhjeve dhe e sistemit të zgjedhjeve</p>  | <p>Përsëritje-sistemi i zgjedhjeve</p>  |

|                              |   |                                 |
|------------------------------|---|---------------------------------|
|                              | <p>Teoria politike e kushtetuese-juridike dhe sistemi i zgjedhjeve</p> <p>Sistemi i ndarjes së mandateve me rastin e zgjedhjeve</p> <p>Llojet e sistemeve të zgjedhjeve</p> <p>Raporti midis zgjedhësve dhe përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre</p> <p>Roli i partive politike në sistemin e zgjedhjeve</p>   |                                 |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i>   | <p><b>Partitë politike</b></p> <p>Kuptimi i partive politike</p> <p>Paraqitja dhe zhvillimi i partive politike</p> <p>Funksionet e partisë politike</p> <p>Fuqia e partisë politike</p> <p>Karakteret klasor i partive politike</p> <p>Partitë politike si faktorë të demokracisë</p> <p>Ithtarët dhe anëtarët e partive politike</p> <p>Organizimi i partive politike</p> <p>Llojet e partive politike</p> <p>Grupet e interesit</p> | Përsëritje-partitë politike     |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i>  | <p><b>Vetëqeverisja lokale</b></p> <p>Vetëqeverisja lokale, kuptimi dhe përkufizimi</p> <p>Prejardhja dhe zhvillimi i vetëqeverisjes lokale</p> <p>Kushtetet e ekzistimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale</p> <p>Format e vetëqeverisjes lokale</p> <p>Pushteti lokal - dekoncentrimi dhe decentralizimi</p> <p>Vetëqeverisja lokale në Kosovë</p>  | Përsëritje-vetëqeverisja lokale |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | <p><b>Mbrojtja dhe ushtria</b></p> <p>Roli politik i ushtrisë në shtetet dhe sistemet politike të ndryshme</p> <p>Qëndrimi i kushtetutës ndaj mbrojtjes dhe ushtrisë</p>  | Përsëritje-mbrojtja dhe ushtria |



|   |  |  |
|---|--|--|
|   | Mbrojtja dhe ushtria në kushtetutat e vendeve unitare dhe atyre federative<br>Mbrojtja dhe ushtria në Kosovë |  |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>  | <b>Parapërgaditje për provim</b>   | Përsëritje e temave të trajtuara gjatë semestrit |
| <b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>  |  |  |
| <b><i>Studentët janë të obliguar :</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe njëkohësisht të jetë i vëmendshëm në orën mësimore.</li><li>• Plagjiatura dhe fenomenet e ngjashme mashtruese do të ndëshkohen sipas akteve juridike në fuqi.</li><li>• Të respektohet Kodi i Etikës për Studentët i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.</li></ul> |  |  |